

L I G J
NR.7760, DATE 14.10.1993

FZ. 12-1993

PER RATIFIKIMIN E "KONVENTES NDERMJET REPUBLIKES SE SHQIPERISE
DHE GREQISE PER NDIHMEN GJYQESORE NE CESHTJET CIVILE DHE
PENALE"

Ne mbeshtetje te nenit 16 te ligjit nr.7491, date 29.4.1991 "Per dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikimin e "Konventes ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Republikes se Greqise per ndihme gjyqesore ne ceshtjet civile dhe penale", nenshkruar ne Athine me 17 maj 1993.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi menjehere

Shpallur me dekretin nr.671, date 29.10.1993 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,
Sali Berisha.

K O N V E N T Ë

MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË GREQISË.

"MBI NDIHMËN GJYQËSORE NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE"

Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë duke i dhënë rëndësi të madhe bashkëpunimit midis dy vendeve në fushën e marrëdhënieve gjyqësore, vendosën të lidhin një Konventë lidhur me ndihmën gjyqësore në çështje civile dhe penale.

Kryeministri i Republikës së Shqipërisë dhe Kryeministri i Republikës së Greqisë të cilët pasi shkëmbyen dokumentat përkatës, të cilët u vërtetuan se ishin hartuar si duheshin vendosën dispozitat që vijojnë:

KAPITULLI I PARË

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Mbrojtja ligjore

1. Shtetasit e secilës Palë kontraktuese do të gëzojnë në tokën e Palës tjetër kontraktuese të njëjtën mbrojtje ligjore me atë të shtetasve të Palës tjetër lidhur me të drejtat personale dhe ato pasurore.

2. Shtetasit e secilës Palë kontraktuese kanë të drejtë të drejtohen lirisht në gjykatë, në autoritete të prokurorisë dhe noterisë (që këtej e tutje do të quhen "autoritete gjyqësore") kompetenca e të cilëve përfshin çështje që rregullohen nga kjo Konventë, si edhe në autoritete të tjera të Palës tjetër kontraktuese. Munden të paraqiten, të bëjnë lutje dhe të ngrenë padi para këtyre

autoriteteve me të njëjtat kushte si dhe Shtetasit e Palës tjetër Kontraktuese.

3. Dispozitat e Kapitullit I të kësaj Konvente janë të vlefshme zbatohen në heshtje edhe ndaj personave juridikë të të dy Palëve Kontraktuese.

Neni 2

Ndihma gjyqësore

1. Autoritetet gjyqësore të të dyja palëve Kontraktuese do të japin, reciprokisht, ndihmë gjyqësore në çështje civile, duke përfshirë edhe ato tregtare e familjare si edhe në çështje penale.

2. Autoritetet gjyqësore do t'u japin ndihmë gjyqësore autoriteteve të tjera, kompetenca e të cilave shtrihet në çështjet që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 3

Mënyra e komunikimit

Autoritetet gjyqësore të Palëve Kontraktuese do të komunikojnë midis tyre, për qëllimet e ndihmës gjyqësore, me anë të organeve të tyre qendrore, dmth. nga ana e Republikës Greke me anë të Ministrisë së Drejtësisë dhe nga ana e Republikës së Shqipërisë me anë të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Prokurorisë së Përgjithshme. Mundësia e përdorimit të rrugës diplomatike nuk përjashtohet.

Neni 4

Shtrirja (hapësira) e ndihmës gjyqësore

Autoritetet gjyqësore të Palëve Kontraktuese do të ofrojnë ndihmë gjyqësore të ndërsjelltë duke kryer veprime të ndryshme procedurale dhe veçanërisht transmetim dhe dorëzim dokumentash, kryerje

kërkimesh, vënia dorë dhe dorëzim provash, kryerje ekspertize, marrje në pyetje të të akuzuarve, dëshmitarëve, ekspertëve, paditësve e të të paditurve dhe të personave të tjerë si dhe autopsi gjyqësore.

Neni 5

Përmbajtja e porosive gjyqësore

1. Porosia gjyqësore duhet të përmbajë elementat që vijojnë:
 - a) Emërtimin e autoritetit kërkues
 - b) Emërtimin e autoritetit ndaj të cilit drejtohet kërkesa
 - c) Përcaktim të çështjes për të cilën kërkohet ndihma gjyqësore
 - ç) Emrin, banesën dhe shtetësinë e paditësit e të të paditurit në gjyq, të të akuzuarve, të të pandehurve dhe të të dënuarve
 - d) Emrin dhe adresën e përfaqësuesve të paditësit e të të paditurit në gjyq.
 - dh) Objektin e kërkesës për ndihmë gjyqësore dhe elementët e domosdoshëm për zbatimin e saj dhe,
 - e) në çështjet penale, përshkrimin e krimit dhe cilësimin e veprimit që e rekomandon.

2. Porositë gjyqësore do të kenë nënshkrim dhe vulë.

Neni 6

Zbatimi i kërkesës për ndihmë gjyqësore

1. Për të zbatuar një kërkesë për ndihmë gjyqësore, orga-

ni ndaj të cilit drejtohet kërkesa zbaton legjislacionin kombëtar.

2. Në qoftë se organi ndaj të cilit drejtohet kërkesa për ndihmë gjyqësore nuk është kompetent për zbatimin e saj, ai duhet t'ia kalojë atë autoritetit kompetent.

3. Në qoftë se personi që tregohet në kërkesën për ndihmë gjyqësore nuk gjendet në adresën e dhënë ose është i panjohur, organi ndaj të cilit drejtohet kërkesa duhet të marrë masat e domosdoshme për të identifikuar këtë adresë. Në rastin kur bëhet i pamundur zbatimi i kërkesës për ndihmë gjyqësore, dokumentet i kthehen autoritetit kërkues me shënimin se personi që përmendet në kërkesë nuk u gjend në adresën e dhënë ose adresa e tij nuk u bë e mundur të identifikohet.

4. Pas zbatimit të kërkesës për ndihmë gjyqësore, autoriteti ndaj të cilit drejtohet kërkesa, i kthen dokumentet autoritetit kërkues dhe, në qoftë se nuk bëhet e mundur të zbatohet kërkesa për arsye tjetër, përveç asaj që përmendet në paragrafin (3), njofton arsyet që penguan zbatimin.

Neni 7

Mbrojtja e dëshmitarëve dhe e ekspertëve

1. Asnjë dëshmitarë ose ekspert i çfarëdo kombësie përdërisa paraqitet përpara autoritetit të Palës kërkuese Kontraktuese, pas thirrjes që i jepet nga autoriteti gjyqësor të Palës Kontraktuese, ndaj të cilës drejtohet kërkesa, nuk mund të ndiqet penalisht ose t'i nënshtrohet zbatimit të dënimit për krimin që ka kryer para se të kalojë kufirin e Palës kërkuese.

2. Imuniteti që parashikon paragrafi i mëparshëm, pushon kur dëshmitari ose eksperti, ndërsa ka mundësinë të largohet nga

toka e Palës Kontraktuese brenda pesëmbëdhjetë ditëve të pandërprera, qysh kur autoritetet gjyqësore e njoftuan se prezenca e tij nuk është më e nevojshme, megjithëkëtë qëndron në këtë tokë, ndonëse ka mundësi të largohet. Në këtë afat nuk llogaritet koha gjatë së cilës dëshmitari ose eksperti nuk mundi ta lërë tokën e vendit për arsye të pavarura nga vullneti i tij. Imuniteti pushon, gjithashtu, në rast se dëshmitari ose eksperti kthehet në tokën e Palës kërkuese pas nisjes së tij prej saj.

Neni 8

Dokumente shtetërore

1. Dokumentet që hartohen në tokën e njërës nga Palët kontraktuese ose që sanksionohen (ratifikohen) nga organet e saj brenda kuadrit të kompetencave të tyre, sipas tipit që kërkohet dhe vulës do të bëhen të pranueshme në tokën e Palës tjetër kontraktuese në qoftë se nuk i nënshtrohen një sanksionimi (ratifikimi) të ri.

2. Nuk kanë nevojë, gjithashtu, për sanksionimin/^edokumentave private që janë vlerësuar nga gjykata ose organi tjetër kompetent prej njërës nga Palët kontraktuese, për t'u përdorur në gjykatat dhe në autoritetet e Palës tjetër kontraktuese.

Neni 9

Dorëzimi i dokumenteve

1. Autoriteti ndaj të cilit drejtohet kërkesa kryen dorëzimin sipas procedurës që ka fuqi në shtetin e tij, në qoftë se dokumenti për dorëzim është hartuar (redaktuar) në gjuhën e tij kombëtare apo shoqërohet me përkthim të vërtetuar në këtë gjuhë ose në gjuhën frënge. Në rast të kundërt, dokumenti që do të dorëzohet nuk do t'i jepet marrësit veçse në qoftë se ky i fundit e pranon me vullnetin e tij.

2. Porosia gjyqësore do të përmendë adresën e saktë të marrësit dhe do të caktojë dokumentin që dorëzohet.

Neni 10

Dëftesë e dorëzimit

Autoriteti ndaj të cilit drejtohet kërkesa duhet të japë dëftesë dorëzimi sipas legjislacionit të shtetit të tij. Ky dokument do të përmendë vendin, datën e dorëzimit dhe emrin e personit të cilit ia dorëzon dokumentet.

Neni 11

Dorëzimi në nënshtetas

1. Palët kontraktuese kanë të drejtë t'u dorëzojnë dokumente shtetasve të tyre me anë të misionëve të tyre diplomatike apo konsullore.

2. Asnjë shtrëngim nuk mund të imponohet gjatë zbatimit të kësaj mënyre të dorëzimit.

Neni 12

Shpenzimet e ndihmës gjyqësore

Pala kontraktuese ndaj të cilës drejtohet kërkesa nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve të ndihmës gjyqësore. Çdo njëra nga Palët Kontraktuese merr përsipër të gjitha shpenzimet e ndihmës gjyqësore që u bënë në vendin e saj.

Neni 13

Informacione mbi çështje të së drejtës

Ministritë e Drejtësisë të palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë reciprokisht informacione në bazë të kërkesës, për të drejtën që është në fuqi në vendet e tyre respektive.

Neni 14

Refuzim për dhënie ndihmë gjyqësore

Ndihma gjyqësore mund të refuzohet :

1. Në qoftë se kërkesa ka të bëjë me krime që nga pala kontraktuese, ndaj të cilës drejtohet kërkesa, konsiderohen si politike ose ushtarake.

2. Në qoftë se pala ndaj të cilës drejtohet kërkesa gjykon se kërkesa është e një natyre të tillë që prek sovranitetin, sigurinë apo rendin publik të asaj Pale.

Neni 15

Veprime të gjendjes civile

1. Palët Kontraktuese do të dërgojnë reciprokisht të dhëna për veprime të gjendjes civile lidhur me lindjen, martesën dhe vdekjen që kanë të bëjnë me shtetasit e Palës tjetër kontraktuese po kështu dhe korrigjime e plotësime të mëvonshme në veprimet e lartpërmendura të gjendjes civile.

2. Aktet e gjendjes civile për vdekje do t'u dërgohen pa ndonjë kërkesë palës tjetër kërkuese. Të gjitha do të dërgohen pa shpenzime në rrugë diplomatike.

Neni 16

Dorëzimi i objekteve dhe mbartja (transferimi)

i shumës së parave

Në qoftë se në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, duhet të bëhet dorëzimi, ekspertim ose kalim kredish, me anëpagesë dhe me mall, ky do të bazohet në legjislacionin e shtetit të cilit i drejtohet kërkesa.

Neni 17

Gjuhë

Organet gjyqësore të të dy Palëve kontraktuese në marrëdhëniet midis tyre përdorin gjuhën e tyre kombëtare me përkthim në gjuhën frënge, në qoftë se kjo është e nevojshme. Por aktet dhe

dokumentet që dërgohen, duhet të përkthehen në gjuhën e Palës së cilës i drejtohet kërkesa ose në gjuhën frënge.

KAPITULLI I DYTË

Shpenzime gjyqësore dhe çështje të tjera

Neni 18

Përrjashtim nga dhënia garancie të huajit

Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, duke përfshirë edhe personat juridikë që paraqiten para gjykatave të Palës tjetër kontraktuese dhe të cilët qëndrojnë në tokën e njërës apo tjetrës Palë kontraktuese, nuk i nënshtrohen detyrimit të dhënies garanci të huajit për të vetmen arsye se janë të huaj ose sepse kanë qëndrim ose banesë në tokën e asaj Pale tjetër.

Neni 19

Përrjashtim nga shpenzimet

Nënshtetasit e njërës nga palët kontraktuese përrjashtohen, kur paraqiten në autoritetet gjyqësore të palës tjetër kontraktuese, nga taksat e pullave dhe shpenzimet gjyqësore dhe gëzojnë lehtësi të tjera si edhe të mirëbërësisë falas të ndihmës gjyqësore në kushte të njëjta dhe në të njëjtën masë si edhe shtetasit e Palës tjetër .

Neni 20

Çertifikatat (Vërtetimet)

1. Çertifikatat që kanë lidhje me gjëndjen personale familjare dhe materiale të kërkuesit që dëshiron të përfitojë nga mirëbërësitë që parashikon neni 19, lëshohen nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në tokën e së cilës ai banon.

2. Në qoftë se kërkuesi, i cili dëshiron të përfitojë nga mirëbërësitë e mësipërme nuk ka banesë ose qëndrim në tokë

e njërës apo tjetrës Palë kontraktuese, dokumenti mund të jepet nga misioni diplomatik ose konsullor i shtetit, shtetas i të cilit është kërkuuesi.

3. Autoriteti gjyqësor që vendos lidhur me kërkesën e përjashtimit në bazë të nenit 19 mund të kërkojë informacion plotësues nga organi që lëshon certifikatën.

Neni 21

Parashtrim i kërkesës

Në qoftë se një shtetas i njërës nga Palët kontraktuese, i cili dëshiron të përfitojë nga mir bërësitë që parashikon neni 19, do t'ju parashtojë kërkesë autoriteteve të Palës tjetër kontraktuese, ai mund t'u drejtohet autoriteteve kompetente lokale të banesës ose të qëndrimit të tij. Autoriteti që e mori përsipër u'kalon këtë kërkesë dhe praktikën lidhur me këtë , bashkë me dokumentet që jepen sipas nenit 20, autoriteteve kompetente të Palës tjetër kontraktuese.

Neni 22

Dispozita lidhur me testamentet

1. Testamenti që bëhet nga shtetas të njërës Palë kontraktuese do të jetë i vlefshëm sa i përket tipit në qoftë se është hartuar sipas:

a) Legjislacionit të shtetit në tokën e të cilit u bë,
ose

b) së drejtës së Palës kontraktuese shtetas i së cilës disponuesi ishte në datën që bëri testamentin e tij ose në çastin

e vdekjes së tij, ose

c) legjislacionit të shtetit në tokën e të cilit dhe në hapsirën kohore që parashikon pika b, disponuesi kishte shtëpinë ose qëndrimin e tij.

2. Klauzolat e paragrafit 1 të këtij neni zbatohen, gjithashtu, edhe lidhur me anulimin (revokimin) e testamenteve.

KAPITULLI I TRETË

Njohja dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore

Neni 23

Vendime që i nënështrohen njohjes dhe zbatimit

1. Në bazë të klauzolave (kushteve) që parashikohen nga kjo Konventë, Palët Kontraktuese do të njohin dhe do të zbatojnë në tokën e tyre vendimet që vijojnë, të cilat janë publikuar në tokën e palës tjetër kontraktuese:

a) Vendime e të dhëna lidhur me çështje civile, familjare dhe tregtare;

b) Vendime të dhëna lidhur me çështje penale në çdo rast që ka të bëjë me kërkesat për dëmshpërblim.

c) Vendime arbitrazhi.

2. Pajtime të bëra para gjykatave dhe që ratifikohen ose sanksionohen prej tyre e që barazohen me vendimet gjyqësore të paragrafit 1.

Neni 24

Kushtet e njohjes dhe të zbatimit

Vendimet që parashikohen në nenin 23 njihen dhe zbatohen

në qoftë se plotësojnë kushtet që vijojnë:

a) Në qoftë se legjislacioni i Palës kontraktuese në vendin e së cilës doli vendimi, ky i fundit ka fuqi të padiskutueshme gjyqësore dhe është i zbatueshëm;

b) Në qoftë se sipas legjislacionit të Palës kontraktuese në tokën e së cilës kërkohet zbatimi, gjykata e kësaj Pale nuk është ekskluzivisht kompetente të gjykojë çështjen;

c) Në qoftë se paditësi që mungon në gjyq dhe nuk merr pjesë në gjykimin është ftuar në kohë dhe në mënyrën e duhur ose në qoftë se paditësi që nuk paraqitet edhe që nuk ka mundësi të jetë i pranishëm në gjykatë ka mundur të përfaqësohet ligjërisht. Ftesa me ngjitje në portë (në tabelë) nuk merret parasysh.

ç) Në qoftë se vendimi nuk vjen në kundërshtim me vendimin e mëparshëm që ka fuqi përfundimtare gjyqësore, midis palëve të njëjta, lidhur me të njëjtin objektiv dhe mbi të njëjtën përmbajtje dhe që u muar nga gjykata e Palës kontraktuese në tokën e së cilës vendimi duhet të njihet ose të zbatohet ose në qoftë se asnjë padi nuk është ngritur më parë para gjykatës së kësaj Pale kontraktuese për të njëjtën çështje.

d) Në qoftë se njohja dhe zbatimi i vendimeve nuk vjen në kundërshtim me rendin publik apo me parimet bazë të legjislacionit të Palës kontraktuese në tokën e së cilës duhet të kryhen njohja dhe zbatimi i vendimit.

Neni 25

Vendime të arbitrazhit

1. Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit zbatohen dispozitat e konventës që u nënshkruan në Nju Jork me

10 Qershor 1958.

2. Në rast zhvillimi të gjyqit, objektivi i të cilit, sipas vullnetit të paditësve, (të palëve në gjyq), rregullohet me klauzolë arbitrazhi, gjykata urdhëron Palët t'i drejtohen organit të arbitrazhit.

Neni 26

Dokumenta që shoqërojnë kërkesën e zbatimit

1. Kërkesa relative lidhur me zbatimin e vendimit mund t'i paraqitet direkt gjykatës kompetente të Palës kontraktuese në tokën e së cilës duhet të zbatohet vendimi, por mundet gjithashtu të depozitohet në gjykatën që mori vendimin e shkallës së parë për çështjen konkrete. Në këtë rast të fundit, kërkesa bëhet sipas procedurës të nenit 3, në gjykatën kompetente të Palës tjetër kontraktuese.

2. Kërkesa duhet të shoqërohet:

a) Nga vendimi ose nga kopja e tij e vërtetuar, si edhe nga dokumenti që vërteton se vendimi ka fuqi përfundimtare gjyqësore dhe është i zbatueshëm, përveç rasteve kur kjo rezulton nga vetë vendimi.

b) Nga çertifikata që vërteton se paditësi (pala në gjyq) që mungoi në gjyq dhe që nuk mori pjesë gjatë procedurës, i ftuar në kohë, në mënyrën e përshtatshme dhe se, në rastin që nuk kishte aftësinë të paraqitej në gjyq, u përfaqësua ligjërisht.

c) Nga përkthimi i legalizuar i dokumentave që parashikohen nga pikat a dhe b në një nga gjuhët që parashikohen në nenin 17 të kësaj Konvente.

3. Në rast se kemi të bëjmë me vendim arbitrazhi, përveç

kushteve që parashikohen në paragrafin e 2, kërkesa duhet të shoqërohet nga kopja e legalizuar e klauzolës së arbitrazhit, si edhe nga përkthimi i legalizuar i kësaj klauzole dhe çdo dokumenti tjetër përkatës në një nga gjuhët që parashikohen nga neni 17 i kësaj Konvente.

Neni 27

E drejta zbatuese

1. Gjykata e Palës Kontraktuese në tokën e së cilës duhet të zbatohet vendimi, do ta zbatojë atë në përputhje me legjislacionin kombëtar.

2. Gjykata që vendos për zbatimin e kërkesës përkatëse kufizohet në konstatimin e pajtimit sipas kushteve të përcaktuara në nenet 24, 25 dhe 26 të kësaj Konvente.

3. I padituri mund të paraqesë objeksionet që lejohen nga ligjet e palës kontraktuese, gjykata e së cilës mori vendimin.

Neni 28

Vendime lidhur me shpenzimet gjyqësore

1. Në qoftë se paditësi që u përjashtua, sipas kushteve të nenit 18 të kësaj Konvente nga dhënia garanci për të huajin, u dënua me vendim të prerë të gjykatës së njërës nga Palët Kontraktuese, për shpenzimet gjyqësore, ky vendim do të zbatohet, pas kërkesës së atij që ka të drejtë, pa shpenzime në tokën e Palës tjetër kontraktuese.

2. Gjykata që vendos për zbatimin e vendimit që parashikohet në paragrafin 1 kufizohet në bërjen e vlerësimit në qoftë se vendimi, lidhur me shpenzimet gjyqësore, ka fuqi përfundimtare

gjqësore dhe është i zbatueshëm.

3. Dispozitat e nenit 26 zbatohen edhe në vendimet që u referohen shpenzimeve gjyqësore.

Neni 29

Fusha e zbatimit

Vendimet që parashikohen nga neni 23 dhe që u përgjigjen kushteve të neneve 24, 25 dhe 26 të kësaj Konvente do të njihen dhe zbatohen kur kanë fuqi përfundimtare gjyqësore dhe janë shpallur të zbatueshëm pas vënies në fuqi të kësaj Konvente.

Neni 30

Legjislacioni lidhur me transferimin e parave
dhe të mallrave

Dispozitat e kapitullit III të kësaj Konvente nuk prekin legjislacionin e Palëve kontraktuese që ka të bëjë me transferimin e mjeteve të pagesës, të kredive ose mallrave, që u fituan pas zbatimit.

KAPITULLI I KATËRT

Ekstradimi

Neni 31

Detyrim për ekstradim (dorëzim)

1. Palët kontraktuese marrin përsipër detyrimin të dorëzojnë reciprokisht, sipas dispozitave të kësaj Konvente, personat që ndodhen në tokën e tyre dhe që janë subjekt i ekstradimit, në pritje të kryerjes së ndjekjes penale për të zbatuar dënimin që

vendoset nga gjykata e palës kërkuese.

2. Ekstradimi nuk lejohet veçse për krime që, sipas legjislacionit të të dyja Palëve kontraktuese, dënohen me heqje lirie të paktën një vit ose me dënim më të rëndë ose për krime për të cilat gjykata e palës kërkuese ka marrë vendim për heqje lirie të paktën gjashtë muaj (këtej e tutje do të quhen krime për të cilat lejohet ekstradimi).

Neni 32

Refuzim ekstradimi

Ekstradimi nuk bëhet:

a) Në qoftë se krimi kryhet nga një person që në çastin e kryerjes së krimit ishte shtetas i Palës së cilës i drejtohet kërkesa.

b) Në qoftë se krimi kryhet në tokën e Palës kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa.

c) Në qoftë se krimi, për të cilin kërkohet ekstradimi kryhet jashtë tokës së Palës kërkuese dhe legjislacioni i Palës kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa nuk parashikon ndjekje në rastin që ky krim u krye jashtë tokës së saj ose nuk lejon ekstradimin për krimin që është objekt i kërkesës.

ç) Në qoftë se krimi për të cilin kërkohet ekstradimi konsiderohet nga Pala kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa si krim politik, ushtarak apo tatimor apo si ngjarje që ka të bëjë me krime të tilla.

d) Në qoftë se sipas legjislacionit të njëjës nga Palët kontraktuese ndjekja penale apo zbatimi i dënimit nuk mund të bëhen

për shkak të parashkrimit apo për arësye të tjera ligjore që kanë të njëjtin rezultat.

dh) Në qoftëse në tokën e Palës kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa personi, për të cilin kërkohet ekstradimi, u shpall me vendim definitiv fajtor apo i pafajshëm për krimin që përmendet në kërkesën e ekstradimit apo në qoftë se lidhur me këtë ka pushuar ndjekja penale, përveç në qoftë se vendimi përkatës mbështetet në mungesë juridiksioni.

Neni 33

Procedura e ekstradimit

Kërkesa për ekstradim bëhet me shkrim. Në çështjet e ekstradimit komunikimi do të bëhet në mënyrën që parashikohet në nenin 3.

Neni 34

Kërkesa e ekstradimit

1. Kërkesa e ekstradimit duhet të ketë emrin e personit që kërkohet, banesën ose vendqëndrimin e tij, natyrën e krimit dhe dëmin që shkaktoi.

2. Kërkesa e ekstradimit duhet të shoqërohet:

a) në qoftë se ekstradimi kërkohet që të ushtrohet ndjekja penale, nga mandat arrestimi me përshkrimin e ngjarjeve reale dhe karakterizimin ligjor të veprimit dhe në qoftë se ekstradimi kërkohet për kryerjen e dënimit, nga vendimi që ka fuqi përfundimtare gjyqësore.

b) me tekstin e ligjit penal të Palës kërkuese lidhur me cilësimin ligjor të krimit për të cilin bëhet fjalë.

c) me përshkrimin e jashtëm të personit që kërkohet dhe në qoftë se është e mundur, me shenjat e gishtërinjve dhe fotografi-të e tij.

3. Në qoftë se është fjala për një të dënuar që ka kryer një pjesë të dënimit të tij, do të jepen të dhëna lidhur me këtë gjë.

Neni 35

Arrestim me qëllim ekstradimi

Në qoftë se kërkesa e ekstradimit plotëson kushtet që përcaktohen nga kjo Konventë, Pala Kontraktuese ndaj së cilës drejtohet kërkesa, merr pa vonesë, masat e domosdoshme për arrestimin e personit që kërkohet, në pajtim me legjislacionin e saj.

Neni 36

Informata plotësuese

1. Në qoftë se kërkesa e ekstradimit nuk përmban të gjitha të dhënat e domosdoshme, Pala kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa, mund të kërkojë të dhëna plotësuese dhe të caktojë afat jo më të madh se dy muaj për dhënien e tyre. Ky afat mund të zgjatet për arsye të justifikuara.

2. Në qoftë se të dhënat nuk jepen brenda afatit që parashikohet në paragrafin e parë, autoriteti kompetent i Palës kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa, mund të ndalojë procedurën

e ekstradimit dhe të lirojë personin që është arrestuar.

Neni 37

Arrestimi provizor

1. Në rastet urgjente, Pala kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa, mund të urdhërojë arrestimin e personit të kërkuar para se të marrë kërkesën e ekstradimit sipas nenit 35 të kësaj Konvente. Pala kërkuese Kontraktuese njofton palën kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa se personi për të cilin bëhet fjalë përbën objekt urdhër arrestimi apo vendimi që ka fuqi përfundimtare gjyqësore dhe se kërkesa e ekstradimit do të dërgohet menjëherë. Në raste të tilla, arrestimi mund të kërkohet me çdo mjet komunikimi që transmeton, përmbajtjen e kërkesës, të shkruar.

2. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese mund të kryejnë arrestimin e përkohshëm të personit që qëndron në vendin e tyre, akoma edhe pa kërkesë të tillë, në qoftë se dinë se ky person ka kryer në tokën e Palës tjetër kontraktuese krim për të cilin ka vend (lejohet) ekstradimi.

3. Arrestimi që u bë në bazë të paragrafeve 1 dhe 2 të këtij neni njoftohet përnjëherë Palës tjetër kontraktuese.

Neni 38

Heqja e arrestimit provizor

Cilido që arrestohet sipas nenit 38 të kësaj Konvente lirohet në qoftë se kërkesa e ekstradimit të Palës tjetër kontraktuese nuk merret brenda dyzet ditëve pas arrestimit. Lirimi i njoftohet Palës tjetër kontraktuese.

Neni 39

Shtyrja e ekstradimit

Në qoftë se personi që kërkohet përbën objekt ndjekjeje penale ose kryen dënim për tjetër krim, të kryer në tokën e Palës kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa, ekstradimi mund të shtyhet gjer në mbarimin e procedurës penale apo gjer në kryerjen e dënimit.

Neni 40

Ekstradim provizor

1. Në qoftë se për shkak të shtyrjes së ekstradimit që parashikohet në nenin 39 të kësaj Konvente ekziston rreziku i parashkrimit të ndjekjes penale apo ekzistojnë vështirësi serioze në veprën hetimore personi që kërkohet mund të ekstradohet provizorisht, sipas kërkesës së argumentuar.

Neni 41

Grumbullim kërkesash për ekstradim

Në qoftë se shumë shtete kërkojnë ekstradimin e të njëjtit person, shteti kontraktues të cilit i drejtohet kërkesa vendos se cila kërkesë do të preferohet.

Neni 42

Kufijtë e ndjekjes penale

1. Pa pëlqimin e Palës kontraktuese së cilës i drejtohet

Neni 39

Shtyrja e ekstradimit

Në qoftë se personi që kërkohet përbën objekt ndjekjeje penale ose kryen dënim për tjetër krim, të kryer në tokën e Palës kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa, ekstradimi mund të shtyhet gjer në mbarimin e procedurës penale apo gjer në kryerjen e dënimit.

Neni 40

Ekstradim provizor

1. Në qoftë se për shkak të shtyrjes së ekstradimit që parashikohet në nenin 39 të kësaj Konvente ekziston rreziku i parashkrimit të ndjekjes penale apo ekzistojnë vështirësi serioze në veprën hetimore personi që kërkohet mund të ekstradohet provizorisht, sipas kërkesës së argumentuar.

Neni 41

Grumbullim kërkesash për ekstradim

Në qoftë se shumë shtete kërkojnë ekstradimin e të njëjtit person, shteti kontraktues të cilit i drejtohet kërkesa vendos se cila kërkesë do të preferohet.

Neni 42

Kufijtë e ndjekjes penale

1. Pa pëlqimin e Palës kontraktuese së cilës i drejtohet

kërkesa, personi që u ekstradua nuk mund të jetë objekt i ndjekjes penale apo zbatimit të vendimit që u muar për krim të ndryshëm nga ai për të cilin u bë ekstradimi.

2. Pa pëlqimin e Palës kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa, personi që u ekstradua nuk mund gjithashtu, t'i dorëzohet një shteti të tretë.

3. Pëlqimi që parashikohet në paragrafin 2 nuk është i domosdoshëm.

a) në qoftë se personi që u ekstradua nuk u largua nga toka e Palës kërkuese brenda tridhjetë ditëve prej përfundimit të ndjekjes penale apo zbatimit të dënimit. Ky afat nuk përfshin kohën gjatë së cilës personi që u ekstradua nuk mundi të largohet nga toka e Palës kërkuese kontraktuese për arsye që nuk varen nga vullneti i tij.

b) në qoftë se personi që u ekstradua u largua nga toka e palës kërkuese kontraktuese, por u kthye përsëri me vullnetin e tij.

Neni 43

Dorëzimi i personit që ekstradohet

1. Pala kontraktuese ndaj të cilës drejtohet kërkesa njofton Palën kërkuese për vendin dhe datën e dorëzimit.

2. Në qoftë se personi që kërkohet nuk do merret nga Pala kërkuese kontraktuese brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga afati që është caktuar për dorëzim, ai mund të lirohet.

Neni 44

Të dhëna për rezultatin e ndjekjes penale

Palët kontraktuese japin reciprokisht të dhëna për rezultatet e ndjekjes penale objekt i së cilës ishte personi që u ekstradua. Në rast vendimi me fuqi përfundimtare gjyqësore (të formës së prerë) Palët kontraktuese njoftojnë reciprokisht këtë vendim.

Neni 45

Kalimi

1. Palët kontraktuese lejojnë, sipas kërkesës së njërës palë, kalimin nga toka e tyre të personave që janë ekstraduar nga një shtet i tretë në atë të Palës tjetër kontraktuese. Palët kontraktuese nuk janë të detyruara të lejojnë kalimin në qoftë se nuk ekziston detyrimi për ekstradimin sipas kësaj Konvente.

2. Kërkesa për dhënien e lejes së kalimit bëhet sipas një procedure të njëjtë me atë të kërkesës së ekstradimit.

3. Kalimi bëhet nga autoritetet e palës kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa në mënyrën që ato konsiderojnë më të mirë.

Neni 46

Shpenzimet e ekstradimit

Shpenzimet e ekstradimit rëndojnë mbi Palën kontraktuese në tokën e së cilës u bënë. Shpenzimet e kalimit rëndojnë mbi palën kërkuese kontraktuese.

Neni 47

Marrja përsipër e procedurës penale

1. Palët kontraktuese detyrohen të ushtrojnë sipas kërkesës së palës tjetër dhe në përputhje me legjislacionin e tyre, ndjekjen penale ndaj shtetasve të tyre që kryejnë krime në tokën e palës tjetër kontraktuese.

2. Kërkesa për ndjekje do të shoqërohet me dokumentet përkatëse të hetimit, me ato elementë prove që ekzistojnë si edhe me tekste të dispozitave penale që rregullojnë veprën në përputhje me ligjin në fuqi në vendin e kryerjes së tij.

3. Pala kontraktuese të cilës i drejtohet kërkesa njofton palën kërkuese kontraktuese për rezultatin e ndjekjes dhe pasi të dalë vendimi, i dërgon kopje të vendimit të formës së prerë.

Neni 48

Dorëzimi provizor i personave të arrestuar

Në qoftë se lidhur me ndjekjen penale që filloi në tokën e njërës prej palëve kontraktuese, është e nevojshme të merret në pyetje provizorisht, si dëshmitar personi që u arrestua në tokën e palës tjetër kontraktuese, kjo palë e ekstradon provizorisht atë kur është dakord edhe personi që u arrestua, sipas kërkesës të palës kërkuese kontraktuese që mban këtë person në arrest dhe me përfundimin e marrjes në pyetje do t'ia ridërgojë pa vonesë palës tjetër kontraktuese, së cilës i drejtohet kërkesa.

Neni 49

Dorëzimi i objekteve

1. Objektet që ndodhen në pronësi të personit që kreu veprën për të cilën mund të zbatohet ekstradimi si edhe objektet e tjera që mund të përdoren si prova në procedurën penale i dorëzohen Palës kërkuese kontraktuese edhe në rastin që ekstradimi nuk mund të bëhet për shkak të vdekjes së personit që kërkohet ose për tjetër shkak.

2. Pala kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa mund të shtyjë dorëzimin e objekteve në qoftë se ato nevojiten për një tjetër procedurë penale.

3. Të drejtat e të tretëve mbi objektet që ju dorëzuan Palës tjetër kontraktuese mbeten të paprekura. Pas përfundimit të procedurës penale, këto objekte i jepen palës kontraktuese që i dërgoi për t'ia dorëzuar përfituesve.

4. Dorëzimi i objekteve në bazë të paragrafit 1 bëhet në përputhje me nenin 16 të kësaj Konvente.

Neni 50

Informacione për vendime në çështje penale

1. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë një herë në vit informacione për vendime lidhur me çështje penale që kanë fuqi përfundimtare gjyqësore (të formës së prerë) që u vendosën nga gjykatat e njërës nga Palët kontraktuese ndaj shtetasve të palës kontraktuese.

2. Pas kërkesës së argumentuar, palët kontraktuese japin reciprokisht informacione për vendime penale që u morën ndaj per-

sonave qe nuk jane shtetas te pales kerkuese kontraktuese.

KAPITULLI I PESTE

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Neni 51

Ratifikimi dhe hyrja ne fuqi

1.Kjo Konvente i nenshtrohet ratifikimit,sipas ligjeve te seciles pale dhe do te hyje ne fuqi ditën e 30-te pas shkembimit te dokumentave te ratifikimit.

2.Kjo Konvente mund te denoncohet me shkrim nga secila prej paleve kontraktuese.Denoncimi do te hyje ne fuqi 6 muaj pas marrjes se njoftimit nga Pala tjeter kontraktuese.

Per vertetimin e sa me siper,Kryeministrat e paleve kontraktuese nenshkruan kete Konvente.

Bere ne Athine,me 17 maj 1993,ne dy kopje ne gjuhët shqipe dhe greke,te cilat kane te njejten vlere.

PER REPUBLIKEN E SHQIPERISE

KRYEMINISTRI



ALEKSANDER MEKSI

PER REPUBLIKEN E GREQISE

KRYEMINISTRI



KOSTANDINOS MICOTAQIS

